




The voice of blind and partially sighted people in Europe



# T'I BËJMË ZGJEDHJET TË ARRITSHME

për votuesit me aftësi të kufizuara në shikim



# SITUATA

## Votimi i arritshëm është i rëndësishëm

Gjatë zgjedhjeve në Evropë, votuesit zgjedhin opsionet e tyre të preferuara në një fletë votimi. Nga mënyra si është projektuar, kjo metodë nuk është **e arritshme** për shumicën e votuesve me aftësi të kufizuara në shikim. Sigurimi i asistentëve për këtë grup votuesish nuk mjafton për të garantuar pjesëmarrje politike të pavarur, të fshehtë dhe të barabartë.

## PROBLEMET




Ne dimë raste të personave që nuk u është dhënë asistencë, dhe raste ku asistenti ka folur me zë të lartë në lidhje me votën.

*Eksperti i EBU*

Votimi me shabllon është i pamundur teknikisht. Çdo fletë votimi është në format A5, dhe në të janë renditur deri në 150 kandidatë me shkrim të vogël.

*Eksperti i EBU*

## MOSPËRPUTHJE



67% e ekspertëve të EBU duan të kenë votimin me shabllon, të cilin e kanë 31% e shteteve në Evropë.

79% e ekspertëve të EBU duan të kenë votimin elektronik, të cilin e kanë 9% e shteteve në Evropë.

# POLITIKËBËRËSIT

## Përmirësimi i ligjeve


Rruga drejt votimit të arritshëm fillon me legjislacionin e mirë elektoral. Politikëbërësit duhet të përcaktojnë një kuadër të qartë dhe të unifikuar. Ata duhet të sigurojnë kushtet më të mira për votimin me asistencë dhe shabllonët. Për t'ua bërë të lehtë të gjithëve që të votojnë, duhet të studiohen të gjitha metodat e votimit.

## LEGJISLACIONI I UNIFIKUAR



- Krijo një ligj për të gjitha zgjedhjet (presidenciale, parlamentare, lokale, evropiane, referendume, etj.) për të shmangur keqkuptimet ose gabimet.
- Përndryshe krijo një ligj me masa bazë për aksesueshmërinë, të cilat vlejné për të gjitha ligjet elektorale.

## VOTIMI ME ASISTENCË



- Lejo që qytetarët me aftësi të kufizuara në shikim të votojnë me cilindo person që ata duan, duke përfshirë pjesëtarët e familjes apo vullnetarët e pikave të votimit.
- Hiq të gjitha kërkesat për dokumentacion që zbatohen për votimin me asistencë, si certifikatat mjekësore apo betimet.
- Kërkoju asistentëve të nënshkruajnë një deklaratë që tregon se i kuptojnë rregullat dhe se i respektojnë dëshirat e votuesit.

## VOTIMI ME SHABLLON



- Aty ku është e mundur, prezanto votimin me shabllon si një mundësi në të gjitha zgjedhjet.
- Trego qartë cila është agjencia përgjegjëse për prodhimin e shabllonëve, për shembull Komisioni i Zgjedhjeve.
- Rekomando një model të unifikuar të fletës së votimit, i cili nuk mund të ndryshohet në nivel lokal.
- Bëje të detyrueshme me ligj që fletët e votimit të vihen në dispozicion në format të arritshëm para ditës së zgjedhjeve.

# POLITIKËBËRËSIT

## Përmirësimi i ligjeve

### METODAT E SHUMËFISHTA




- Lejo votimin elektronik, duke u siguruar që të jetë i arritshëm dhe i disponueshëm për të gjithë shtetasit në pikat e votimit.
- Lejo votimin para kohe për të gjithë shtetasit, në mënyrë që të votojnë me asistentë në pikat e votimit para ditës së zgjedhjeve.
- Lejo votimin në mungesë për të gjithë shtetasit, në mënyrë që të votojnë nga shtëpia, duke përdorur ndriçimin e shtëpisë së tyre.

# KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

## Drejtimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet e arritshme kanë nevojë për **vendime teknike të arsyeshme** dhe implementim të kujdesshëm. Zyrtarët e zgjedhjeve duhet të krijojnë një fletë votimi të arritshme dhe një shabllon të dobishëm. Ata duhet të studiojnë mjete të reja dhe të sigurojnë trajnim të posaçëm për vullnetarët në lidhje me të drejtat dhe nevojat e votuesve me aftësi të kufizuara në shikim.

## MODELI I FLETËS SË VOTIMIT




- Krijo një model të unifikuar të fletës së votimit me kufij të përcaktuar për përdorimin e shabllonit, përcakto madhësinë minimale të shkrimit dhe llojin e lexueshëm të shkrimit.
- Nëse për zgjedhjet ka disa fletë votimi, krijo një model të dallueshëm ose tituj të ndryshëm për fletët e votimit të ndara sipas ngjyrave.
- Shpo ose prit cepin për të treguar cila është faqja e parë e fletës së votimit.

# KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

## Drejtimi i zgjedhjeve

### MODELI I SHABLLONIT



- Siguro shabllonë plastikë me shkrim brail dhe shkronja të mëdha me kontrast të lartë.
- Në vendet ku përdoren fletë të mëdha votimi, krijo formate të zvogëluara për të gjithë votuesit.
- Prodhoni dokumente audio për të marrë informacionet e fletës së votimit në pikën e votimit.
- Finalizoj fletët e votimit të paktën 30 ditë para zgjedhjeve, me qëllim që të sigurosh kohë të mjaftueshme për prodhimin e shabllonëve dhe dokumenteve audio.

### MJETET E REJA




- Siguro lupa në të gjitha pikat e votimit për shtetasit që kanë kufizime në shikim.
- Siguro kufje dhe pajisje luajtjeje në të gjitha pikat e votimit.



- Vendos një linjë telefonike para zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve për të siguruar ndihmë të shpejtë për vullnetarët dhe për votuesit.
- Provo përdorimin e stampave në vend të lapsave për të gjithë votuesit, për të ndihmuar votuesit që kanë kufizime në lëvizje.
- Vendos një kabinë votimi pranë, në mënyrë që votuesi dhe asistenti të komunikojnë lirshëm me njëri-tjetrin.

## SEANCAT E TRAJNIMIT



- Zhvillo mësimet trajnimi të detyrueshme për zyrtarët dhe vullnetarët e zgjedhjeve që janë të pranishëm në pikën e votimit, duke përfshirë komponentë trajnimi lidhur me pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me ekspertë nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara në shikim.
- Siguro burimet e nevojshme në mënyrë që të gjithë zyrtarët dhe vullnetarët e zgjedhjeve të bëjnë trajnimin.

# RRUGA DREJT SË ARDHMES


## Histori Suksesi në Evropë



Votuesit e BPS në **Finlandë** mund ta zgjedhin asistentin e tyre pa pasur asnjë kufizim. Gjithashtu, në çdo pikë votimi gjendet një asistent i trajnuar në mënyrë specifike. Përveç kësaj, votuesve u lejohet të votojnë para ditës së zgjedhjeve nga shtëpia me anë të postës ose në komunë.



Shabllonët janë provuar për herë të parë në **Gjermani** në vitin 1980. Federata Gjermane e të Verbërve dhe Atyre me Kufizime në Shikim prodhon shabllonë në emër që qeverisë dhe merr financimin e nevojshëm për këtë detyrë. Shabllonët u dërgohen personave BPS me kërkesë para zgjedhjeve, së bashku me një CD shpjeguese për çdo rreth votimi, i cili prodhohet gjithashtu nga Federata.



Votimi elektronik pritet të prezantohet në **Bullgari** në vitet e ardhshme. Sipas Kodit Zgjedhor, makineritë e votimit duhet të përfshijnë “akses të lehtësuar për votuesit me aftësi të kufizuara në shikim”. Gjykata e lartë deklaroi gjithashtu se pikat e votimit duhet të jenë të pajisura me makineri votimi.

## **KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

### **PIKA 29**

Për t'u siguruar që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë të efektshme dhe të plotë në jetën politike dhe publike në mënyrë të barabartë ... inter alia:

- i. Duke u siguruar që procedurat, ambientet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të arritshme dhe të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u përdorur;
- ii. Duke mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të votuar në mënyrë të fshehtë në zgjedhje dhe në referendume publike ... duke mundësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja aty ku është e përshtatshme;

- iii. Duke garantuar respektimin e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si votues, dhe aty ku është e nevojshme, me kërkesën e tyre, duke lejuar asistencën në votim nga një person që ata zgjedhin.

## **INFORMACION RRETH VOTIMIT TË AKSESUESHËM**

Mund ta shikoni Raportin e Studimit për Votimin e Arritshëm në Evropë, si dhe informacione të tjera në lidhje me aktivitetet tona në <http://tiny.cc/93vwjz>

---

## **KONTAKT**

European Blind Union  
6 rue Gager-Gabillot  
75015 Paris  
[ebu@euroblind.org](mailto:ebu@euroblind.org)



Projekti financohet nga “Programi i të Drejtave, Barazisë dhe Qytetarisë” i Bashkimit Evropian.